



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



14-111/01-161247/18

Dt.06.07.2018

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për informatikë	Zëvendësim	2
2	ShML	Mësimdhënës/e për informatikë	Vend i lirë	1
3	ShML	Mësimdhënës/e për piano	Vend i lirë	4
4	ShML	Mësimdhënës/e për dirigjim	Zëvendësim	1
5	ShML	Mësimdhënës/e për violinë	Vend i lirë	1
6	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e elektroteknikës dhe telekomunikacionit	Vend i lirë	1
7	ShML	Mësimdhënës/e për gjeodezi	Vend i lirë	1
8	ShML	Mësimdhënës/e për ndërtimtari	Zëvendësim	1
9	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Fizioterapi (Kujdesi shëndetësor me rehabilitim, bazat e masazhës, terapia fizikale etj.)	Vend i lirë	2
10	ShML	Mësimdhënës/e për edukatë fizike	Vend i lirë	1
11	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë muzikore	Vend i lirë	1
12	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e ekonomisë	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësues

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHT-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për teknologji - informative në shkollë të mesme të ultë:

- Fakulteti i Edukimit – programi: teknologji – informatikë
- Fakulteti i Edukimit – programi: matematikë - informatikë

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për teknologji - informatikë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i edukimit – programi Masteri Mësimdhënies në teknologji - informatikë dhe TIK;
- FSHMN – dega shkencat kompjuterike;
- FSHMN – dega e matematikës;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar);

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për piano në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës - Dirigjim (kompletuar).
- Master i muzikës - Piano ose master i pedagogjisë instrumentale
- Master i muzikës – Pedagogji e përgjithshme (me punim masteri në Pedagogji Pianistike).

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për dirigjim në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës - dirigjim (Kompletuar)
- Master i muzikës - Dirigjim
- Master i pedagogjisë muzikore (me punim masteri në dirigjim koral).

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për violinë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës)

Kriteret e kualifikimit për mësues/e nga fusha e elektroteknikës dhe telekomunikacionit në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i elektroteknikës/komunikacionit;
- Inxh. i elektroteknikës/komunikacionit.

Kriteret e kualifikimit për mësues/e për gjeodezi në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i gjeodezisë;
- Inxh. i diplomuar i gjeodezisë.

Kriteret e kualifikimit për mësime/ndërtimtarë në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i ndërtimtarisë/arkitekturës;
- Inxh. i diplomuar i ndërtimtarisë/arkitekturës.

Kriteret e kualifikimit për mësime/ndërtimtarë për profilin arsimor; Fizioterapi, në shkollë të mesme të lartë:

- Master i fizioterapisë;
- Fizioterapeut i diplomuar.

Kriteret e kualifikimit për mësime/ndërtimtarë për edukatë fizike në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve;
 - Master
 - Sistemi katërvjeçar
 - Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime/ndërtimtarë për edukatë muzikore në shkollë të mesme të ulët:

- Fakulteti i Arteve – dega e arteve muzikore – programi pedagogji e përgjithshme muzikore;

Kriteret e kualifikimit për mësime/ndërtimtarë nga fusha e ekonomisë në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i ekonomisë ;
- Ekonomist i diplomuar.

SQARIM: Në institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ETCS, përkatësisht 5 vite studime.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur për institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të studimeve 4 vjeçar.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kritere:

Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe

Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbliidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në ëeb faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/>(konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2018, por në varësi të lirimt real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2018 – gusht, 2019 (komplet viti shkollor). Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **06/07/2018 deri më datën 20/07/2018.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.